



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	16.08.2023	3	vetë qoftë Vetë
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojç Prilog Appendix	Sakta Kolicina Quantity
SPKMBTK	5692	2023	116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.943/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti - Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.943/2023 të datës 11.07.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Agjencia e Punësimit Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 16.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Shkresa/Përgjigjja në kërkesë me Nr.protokoli 998 e datës 27.06.2023 dhe
- II. Lënda Kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e datës 31.05.2023 të parashtruar nga ankuesi
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore në zbatim të vendimit si në pikën I të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

## Arsyetim

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi) i punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, me datë 11.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë me numër të protokollit 998 të datës 27.06.2023 të Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të rregullores (QRK) Nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Punësimit, ndërsa kjo e fundit më datë 18.07.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5109/2023 të datës 11.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër të protokollit 998 të datës 27.06.2023 të Zv. Drejtoreshës së Përgjithshme të Agjencisë së Punësimit; Kërkesën me numër të protokollit 72 të datës 26.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në organin e punësimit; Emalin e datës 26.06.2023; Kërkesë për aktivizim në qasjen e SIMFK 2023 e datës 23.06.2023; Autorizim për qasje në SIMFK V7 e datës 12.04.2019; Certifikatë e datës 20.03.2019; Vendim me numër 325 i datës 28.02.2019; Përgjigjen në ankesë të datës 18.07.2023; Akt emërimit e ankuesit me numër të protokollit 278 të datës 01.07.2019; Kërkesën me numër të protokollit 897 të datës 31.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në organin e punësimit; Vendim me numër 22 i datës 11.01.2023; Emërimi dhe fletëdeponimi i nënshkrimeve; Kërkesë për krijim ose editim të përdoruesit në SIMFK e datës 11.01.2023; Letërnjoftimi i ankuesit; Emalin e datës 12.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas shqyrtimit të provave materiale të parashtruara nga pala në procedurë, konstatoi se është e domosdoshme që çështja që është objekt i kësaj ankese të kthehet në Rishqyrtim te Organi i njëjtë që ka vendosë në lidhje me këtë çështje përkatësisht te Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhe se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Punësimit dhe se i njëjti sipas Akt emërimit të ankuesit me numër të protokollit 278 të datës 01.07.2019 mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim të Cilësisë dhe Certifikim, ankuesit i janë deleguar detyrat për zyrtar alternativ certifikues/aprovues në zëvendësim të koleges e cila gjendet në pushim të lehonisë pran institucionit të Agjencisë së Punësimit, sipas Vendimit me numër 22 te datës 11.01.2023 nga zv.Drejtor i Përgjithshëm i APRK-së.

Ankuesi me datë 31.05.2023 parashtron kërkesë te organi i punësimit për kompensimin e shtesës në pagë për shkak të përgjegjësi dhe detyrave shtesë të deleguara sipas vendimit me numër protokollit 22 të datës 11.01.2023 të Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit, ndërsa e njëjta përmes përgjigjes në kërkesë të datës 27.06.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit për kompensimin e shtesës në pagë, me arsyetimin se nuk janë përmbushë kriteret konformë dispozitave të nenit 9 paragrafit 10 të rregullores (QRK) Nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës duke kundërshtuar Përgjigjen me numër të protokollit 998 të datës 27.06.2023 të Zv.Drejtoreshës së Përgjithshme të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të rregullores (QRK) Nr.08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik me pretendimin se e drejta e kompensimit për detyra dhe përgjegjësi shtesë bazohet në Rregulloren QRK Nr.08/2023 për Shtesat e të Punësuarve në Sektorin Publikë andaj kërkon që Këshilli ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën dhe të detyroj organin e punësimit në këtë rast Agjencinë e Punësimit, që ankuesit ti bëjë kompensimin me shtesë në pagë për vëllim në punë për periudhën nga data 26.01.2023 deri me datë 23.06.2023.

Me dispozitat e nenit 23 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, është përcaktuar: *"..2. Drejtori ekzekutiv mund t'ua delegojë detyrat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni drejtuesve të njësi administrative të institucionit. Në këtë rast, ai mbetet përgjegjës për mbikëqyrjen e detyrave të deleguara, dhe 3. Drejtori ekzekutiv krijon një regjistër, në të cilin përcaktohen aktet e delegimit, detyrat dhe fusha e delegimit, personit të cilit i është deleguar dhe periudha e vlefshmërisë të delegimit"*, nga rrjedhë se zv.Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës mund të delegoj detyra të udhëheqësit e njësi të agjencisë, ndërsa, këta të fundit janë të obliguar që detyrat e deleguara ti ushtrojnë me përgjegjësi dhe në pajtim me dispozitat e nenit 25 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë ku parashihet: *2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.*

Në kuptim të së drejtës së ankuesit në kompensim për punë shtesë dhe duke marrë parasysh se periudha e kompensimit sipas ankesës i referohet periudhës kohore nga data 26.01.2023 deri me 23.06.2023, Kolegji i Këshillit konstaton faktin së çështja e kompensimit të shtesave për nëpunësit civil është rregulluar me Ligjin 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i cili është në fuqi nga data 05.02.2023.

Ligji 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik me nenin 22 paragrafi 1 ka përcaktuar shtesat që mund përfitohen nga zyrtaret publikë si : *1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e*

sistemit shëndetësor; 1.9. shitesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shitesa funksionale. Ndërsa me nenin 28 është rregulluar mënyra e përfitimit të shtesës për vëllimin e punës ku parashihet se: "1. Organizatat buxhetore, në rastet e parashikuara nga ky ligj, mund të japin shtesën për vëllim të punës, për kryerjen e punës për shkak të rritjes së vëllimit të punës, nëse kanë mjete në dispozicion për këtë qëllim nga kursimet e fondeve të pagave që krijohen për shkak të mungesës së nëpunësve/ve civil, apo pozitive të paplotësuara për të cilat janë paraparë mjete në planin financiar të shfrytëzuesit buxhetor dhe fonde për projekte të veçanta. 2. Nëpunëset/it civil përfitojnë shtesën për shkak të rritjes së vëllimit të punës, për punën e kryer dhe që tejkalon rezultatet e pritshme të punës në një (1) muaj, nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet një mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës si dhe buxheti. 3. Shtesa për vëllimin e punës miratohet nga zyrtarja/i kryesor administrativ i institucionit, pas marrëveshjes me nëpunësen/in civil për të punuar me vëllim të shtuar. 4. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 5. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 6. Rregullat për fitimin, vlerën e shtesës si dhe periudhën e përfitimit përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe me pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike. 7...."

Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik përkatësisht me nenin 9 të kësaj rregullore janë përcaktuar kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës për vëllimin e punës si: 1. Shtesa për vëllimin e punës mund të përfitohet nëse në këtë mënyrë është e mundur të sigurohet në mënyrë më racionale arritja e rezultateve të punës, si dhe buxheti. 2. Udhëheqësi i Njësisë dhe/apo Zyrtari Kryesor Administrativ mund t'i kërkojë një apo më shumë nëpunësve civil që të angazhohen me vëllim të shtuar të punës për një periudhë të caktuar kohore që nuk e tejkalon një (1) vit. 3. Periudha kohore e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të vazhdohet me marrëveshje të re dhe pëlqimin e të dyja palëve. 4. Në asnjë rast totali i periudhës në të cilën nëpunësi civil punon me vëllim të shtuar nuk mund të kalojë periudhën prej dy (2) viteve të njëpasnjëshme. 5. Shtesa për vëllimin e punës miratohet me lidhjen e marrëveshjes nga zyrtari kryesor administrativ i institucionit me nëpunësin civil për të punuar me vëllim të shtuar, sipas Shtojcës 1, pas konfirmimit nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa se nuk është tejkaluar limiti buxhetor, konform njoftimit të përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni. 6. Vlera e shtesës për vëllim të punës është deri në njëzetë përqind (20%) e pagës bazë të nëpunësit civil. 7. Shtesa për vëllimin e punës duhet të ndërpritet në momentin e pushimit të ekzistimit të rrethanave për të cilën është dhënë shtesa. 8. Përderisa nuk përcaktohet ndryshe me ligj, tërësia e shtesave të dhëna sipas këtij neni nuk mund të jetë më e lartë se 0.5% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtarëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit fiskal. 9. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 10. Ministri përkatës për financa, brenda kufizimeve ligjore, priorizon shpërndarjen e fondeve në dispozicion për shtesën e vëllimit të punës sipas paragrafit 8 dhe 9 të këtij neni tek institucionet dhe i njofton, duke marrë parasysh kriteret si në vijim: 10.1. numrin e të punësuarve në Organizatën Buxhetore dhe mungesat e stafit; dhe 10.2. organizatat buxhetore ku fusha e përgjegjësisë administrative e dy (2) apo më shumë ministrive është bashkuar/fuzionuar në një ministri. 11. Ministria përgjegjëse për financa ka për obligim që të sigurohet se totali i shtesave për vëllim të punës, nuk tejkalon kufirin e përgjithshëm buxhetor të

*përcaktuar me legjislacionin në fuqi''*. Andaj bazuar në këtë përcaktim ligjor të potencuar si më lartë Kolegji vlerëson se nga shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në këtë procedurë nuk mund të konstatohet fakti se nëse janë ndërmarrë të gjitha veprimet adekuate administrative nga Institucioni përkatësisht Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës me qëllim që të kërkesa të trajtohet konformë dispozitave ligjore që rregullojnë hollësisht çështjen që është objekt i kësaj ankese, sepse nga analizimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Vendimit me numër protokollit 22 të datës 11.01.2023 është konstatuar se ankuesi ka qenë i ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi shtesë, kështu që e drejta për kompensim e shtesës për vëllim të punës i takon vetëm nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik deri në shfuqizimin e vendimit për delegim të detyrave dhe nëse janë respektuar procedurat që parashohin një të drejtë të tillë, e jo edhe për periudhën në të cilin ka qenë në fuqi Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë i cili nuk ka njohur shtesën për vëllim të punës, por se Institucioni me faktin se Ligji 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka hy në fuqi nga data 05.02.2023 dhe poashtu Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ka hy në fuqi më datë 06.02.2023 e cila rregullore në mënyrë të hollësishme rregullon çështjen e kompensimit me rastin e vëllimit të shtuar të punës, ka pasur obligim ligjorë që të zbatojë dispozitat ligjore në këtë kontekst dhe që ndërliqhen me çështjen që është objekt i kësaj ankese përkatësisht ka qenë dashtë që të ndërmerren veprimet adekuate ligjore-administrative në zbatim të obligimeve që derivojnë nga Rregullorja (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik ,e për të cilat veprime siç u tha më lartë kolegji nuk ka mundur të konstatojë këto rrethana se të njëjtat veprime administrative janë ndërmarrë në kohë dhe afate ligjore qoftë nga institucioni e poashtu edhe nga ankuesi në zbatim të legjislacionit të përcaktuar si më lartë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga ajo që u tha si më lartë përkatësisht si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi obligon Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative konformë Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe të rishqyrtojë kërkesën e ankuesit të datës 31.05.2023 dhe të vendosë meritorisht për kërkesën me akt administrativë i cili duhet të jetë konformë nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga se përgjigjja në kërkesë e datës 27.06.2023, nuk është në harmoni me këto dispozita të LPPA-së dhe e njëjta edhe mbi këtë bazë u shfuqizue si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në at që u tha si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.943/2023, datë 16/08/2023.

**Vjollca SINANI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshme në APRK-së;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në APRK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

